

Titulli i lëndës: GRAMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE

Informatat themelore për lëndën																	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës Shqipe																
Titulli i lëndës:	Gramatikë historike e gjuhës shqipe																
Niveli:	BA (Baçelor)																
Statusi i lëndës:	Obligative																
Viti i studimeve:	Viti IV Semestri VIII																
Numri i orëve në javë:	4+2																
Kreditë ECTS:	7 ECTS																
Orari i mësimit:	<table border="1"><thead><tr><th></th><th>Dita</th><th>Ora</th><th>Salla</th></tr></thead><tbody><tr><td rowspan="2">Ligjëratat</td><td>E mërkurë</td><td>10:30-13:30</td><td rowspan="2">76</td></tr><tr><td>E martë</td><td>11:00-12:00</td></tr><tr><td rowspan="2">Konsultimet</td><td>E mërkurë</td><td>13:30-14:30</td><td rowspan="2">68</td></tr><tr><td>E enjte</td><td>12:00-13:00</td></tr></tbody></table>		Dita	Ora	Salla	Ligjëratat	E mërkurë	10:30-13:30	76	E martë	11:00-12:00	Konsultimet	E mërkurë	13:30-14:30	68	E enjte	12:00-13:00
	Dita	Ora	Salla														
Ligjëratat	E mërkurë	10:30-13:30	76														
	E martë	11:00-12:00															
Konsultimet	E mërkurë	13:30-14:30	68														
	E enjte	12:00-13:00															
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Shpëtim Elezi																
Të dhënat kontaktuese:	shpetim.elezi@uni-pr.edu																
Përshkrimi i lëndës:	<p><i>Gramatika historike e gjuhës shqipe</i> është lëndë që studion sistemin gramatikor të gjuhës shqipe në rrafshin diakronik. Kjo lëndë përshkruan zhvillimin e strukturës gramatikore të shqipes në diakroni duke hetuar proceset, dukuritë dhe mjetet gramatikore të zhvilluara në periudha të ndryshme zhvillimore që nga kohët më të lashta e gjer më sot. Kursi është sintezë e dijeve lidhur me strukturën gramatikore të gjuhës shqipe të zhvilluar në vertikalen historike, duke i ofruar studentit kryesisht njohuri të përgjithshme e të përmbledhura mbi teza e kundërteza të ndryshme rreth formave e formanteve gramatikore të shqipes të zhvilluara në planin diakronik. Për trajtime më të specializuara të çështjeve, kursi e orienton studentin duke i ofruar bibliografi të përzgjedhur.</p>																
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë është ndër kurset formuese që synon t'u ofrojë studentëve njohuri gjithëpërfshirëse për zhvillimin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe në planin diakronik. Qëllimi është që studentët t'i thellojnë dijet e tyre në lidhje me zhvillimin e strukturës së shqipes në diakroni në një dimension sistemi të pashkëputur nga shqipja aktuale gjer në fazat më të largëta indoevropiane. Format dhe formantet gramatikore ndriçohen e rindërtohen përmes metodës historiko-krahasimtare të jashtme (krahasimi i shqipes me gjuhët e tjera IE) dhe përmes krahasimit të brendshëm (krahasimi i strukturës së shqipes aktuale me atë të shqipes së shekujve XVI-XVIII dhe me atë të të folmeve të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë). Në këtë kurs një vend me peshë zënë fazat e zhvillimit të sistemit gramatikor të shqipes, rrafshet dhe shtresat e zhvillimit të këtij sistemi, duke e parë strukturën gramatikore të shqipes edhe në raport me gjuhët e rajonit të Ballkanit dhe në raport me gjuhët indoevropiane, mënyra e studimit të formave e të formanteve gramatikore të gjuhës dhe mjetet themelore të këtij studimi. Njohja dhe familjarizimi me konceptet dhe zhvillimet themelore në këto studime është një nga synimet kryesore të kursit. Në të shtrohen mendime, teza e kundërteza rreth etimologjisë së</p>																

	formave e të formanteve gramatikore të shqipes dhe problemeve themelore të historisë së zhvillimit të gjuhës shqipe, si dhe jepen orientimet bazë bibliografike për çështjet e shtruara.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan proceset e dukuritë gramatikore dhe format e formantet morfologjike të shqipes të përfuara në diakroni. • rindërton strukturën gramatikore të shqipes të zhvilluar në planin diakronik. • heton shtresën e dukurive gramatikore IE (indoevropiane), shtresën e dukurive ballkanike dhe shtresën e dukurive gramatikore të veçanta që shfaqen në strukturën gramatikore të shqipes. • përshkruan fazat e zhvillimit të formave gramatikore të shqipes që nga gjuha IE dhe protoshqipja e gjer më sot. • krahason konkordancat gramatikore të shqipes me ato të gjuhëve të tjera IE dhe ballkanike. • krahason tezat dhe kundërtezat e studiuesve lidhur me prejardhjen e formave dhe formanteve gramatikore. • argumenton lidhur me prejardhjen dhe zhvillimin e formave dhe formanteve gramatikore të shqipes. • analizon veçori të sistemit gramatikor të shqipes të zhvilluar në diakroni.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	4	15	45
Ushtrime	2	15	22.5
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimsdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	3	15	33.75
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	4	15	45
Përgatitja për provimin final	2	4	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	4	1	4
Totali			180.75 orë 180.75:25=7.23 7 ECTS

Metodat e mësimsdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.</p> <p>Mësimdhënia gjatë ligjëratave organizohet nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara, kurse gjatë ushtrimeve mësimsdhënia orientohet kah studentët. Në orët e ushtrimeve mësimsdhënësi e menaxhon dhe lehtëson rrjedhën e orës, duke krijuar mundësi që studentët të diskutojnë e të japin mendime të argumentuara lidhur me zhvillimin diakronik të strukturës gramatikore të shqipes, kurse sipas nevojës shpjegon e sqaron konceptet e diskutueshme e të paqarta.</p> <p>Studentët do të kenë detyra të vazhdueshme në klasë dhe në shtëpi dhe punime seminari të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, si dhe realizojnë projekte që i prezantojnë në klasë për të cilat diskutojnë bashkërisht.</p>
--------------------------	--

Metodat e vlerësimit:

Ka dy mënyra të vlerësimit: vlerësimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi përfundimtar.

a) Në kuadër të vlerësimit të vazhdueshëm aplikohen disa metoda vlerësimi:

Metodat e vlerësimit	Përqindja
1. Pjesëmarrja aktive (L+U)	10%
2. Detyrat individuale (U)	10%
3. Punim seminari (studim rasti)	10%
4. Prezantimi	10%
5. Kolokuiumi I (vlerësimi intermediar)	30%
6. Kolokuiumi II (vlerësimi final)	30%
Totali	100%

Kolokuiumi I mbahet në javën e 7-të (më 1.4.2026) dhe *kolokuiumi II* në javën e 15-të (më 27.5.2026).

Temat e punimeve të seminarit caktohen në javën e 2-të dhe dorëzohen në javën e 11-të në formë elektronike në e-mailin zyrtar. Prezantimi i hulumtimeve bëhet në javën e 14-të. Vërejtjet lidhur me detyrat dhe punimet jepen gjatë orarit të konsultimeve.

Pikët e akumuluar nga mjetet e lartcekura të vlerësimit sipas përqindjes së caktuar evidentohen në modulën e vlerësimit të vazhdueshëm në SEMS.

b) *Vlerësimi përfundimtar* organizohet me shkrim dhe me gojë. Kjo mënyrë vlerësimi aplikohet në rastet kur nuk arrihet sukses me anë të vlerësimit të vazhdueshëm.

Shënim. Pragu i kalueshmërisë është 50%: 51 – 60% (nota 6), 61 – 70 (7), 71 – 80 (8), 81 – 90 (9), 91 – 100 (10).

Literatura bazë:

- Demiraj, Sh. (2002; 2015). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Artini.
- Bokshi, B. (2010). Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes. Prishtinë: ASHAK.
- Topalli, K. (2011). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: QSA.

Literatura shtesë:

- Ajeti, I. (1969). Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike). Prishtinë. Shih edhe në: Studime gjuhësore në fushë të shqipes III. Prishtinë: Rilindja, 1985, ff. 90-225.
- Ajeti, I. (2017). Studime për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK. Në: https://www.ashak.org/repository/docs/StudimeGjuhaShqipeldrizAjeti_804438.pdf
- ASHAK (2012). Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. (Punime të konferencës, 10-11 nëntor 2011), ASHAK, Prishtinë. Në: https://www.ashak.org/repository/docs/SHQIPJA_DHE_GJUHET_E_BALLKANIT_-_Konferenca_shkencore_659049.pdf
- Bokshi, B. (1998). Pjesorja e shqipes (Vështrim diakronik). Prishtinë: ASHAK.
- Bokshi, B. (2004). Për vetorët e shqipes. Prishtinë: ASHAK.
- Bokshi, B. (2005). Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes. Prishtinë: ASHAK. (Botimi I, 1980, Prishtinë: ASHAK).
- Bokshi, B. (2009). Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike. Tiranë: ASHSH. (Botimi I, 1984, Prishtinë: Rilindja).
- Bokshi, B. (2014). Varia. Prishtinë: ASHAK. Në:

- https://www.ashak.org/repository/docs/VariaUeb_553423.pdf
9. Cimochowski, W. (2004). Për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.
 10. Çabej, E. (1976). Studime gjuhësore III (pjesa I: Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike). Prishtinë: Rilindja.
 11. Çabej, E. (1986). Studime gjuhësore VII. Prishtinë: Rilindja.
 12. Demiraj, B. (2006). Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “Doktrina” e tij. Prishtinë: ASHAK.
 13. Demiraj, Sh. (1980). Morfologjia historike e gjuhës shqipe, pjesa I-II. Prishtinë.
 14. Demiraj, Sh. (1988). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Prishtinë: Rilindja.
 15. Demiraj, Sh. (1989). Gjuha shqipe dhe historia e saj. Prishtinë: Rilindja.
 16. Demiraj, Sh. (2004). Gjuhësi ballkanike. Tiranë.
 17. Demiraj, Sh. (2015). Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe. Tiranë: ASHSH.
 18. Elezi, Sh. (2018). Sistemi emëror i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit (shek. XVII). Disertacion doktorate. Tiranë: ASA. Në: <https://drive.google.com/file/d/1AhDHI9wzuQOoI1wabp5cVT28ZQ8-oTO/view>
 19. Elezi, Sh. (2019). Sistemi përemëror i shqipes në veprën e Bogdanit. Prishtinë: ZeroPrint.
 20. Fiedler, W. (2004). Das Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555), Prishtinë: ASHAK.
 21. Fiedler, W. (2007). Die Pluralbildung im Albanischen, Prishtinë: ASHAK.
 22. Fiedler, W. (2018). Vergleichende Grammatik der Balkansprachen, Prishtinë: ASHAK.
 23. Hamp, E. P. (2007). Studime krahasuese për shqipen. Prishtinë: ASHAK.
 24. Ismajli, R. (2000). Tekste të vjetra. Pejë: Dukagjini.
 25. Ismajli, R. (2015). Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik. Prishtinë: ASHAK. Në: https://www.ashak.org/repository/docs/RISMAJLI_397704.pdf
 26. Ismajli, R. (2021). Për historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë: ASHAK.
 27. Jokl, N. (2014). Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip. Prishtinë: ASHAK.
 28. Jokl, N. (2017). Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.
 29. Jokl, N. (2019). Gjurmime linguistike historike-kulturore në fushë të shqipes. Prishtinë: ASHAK.
 30. Joseph, B. (2021). Studime albano-ballkanologjike. Prishtinë: ASHAK.
 31. Likaj, E. (2015). Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes. Tiranë: ASHSH.
 32. Orel, V. (2000). A Concise Historical Grammar of the Albanian Language. Leiden/Boston/Koeln.
 33. Pedersen, H. (2003). Studime për gjuhën shqipe. Prishtinë: ASHAK.
 34. Riza, S. (1996-2009). Vepra I-V. Prishtinë: ASHAK.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Zhvillimi i sistemit gramatikor të gjuhës shqipe Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes
Java 2:	Sistemi gramatikor IE; Karakteristikat tipologjike IE të shqipes Ballkanizmat në sistemin gramatikor të shqipes

Java 3:	Dukuritë gramatikore të zhvilluara brenda shqipes Format dhe mjetet gramatikore: mbaresat, prapashtesat, ndërrimet morfonologjike, gjatësia e zanoreve, supletivizmi, tingujt antihiatizues dhe anaptiktikë, fjalët e gramatikalizuara (dëftorët, numërori <i>një</i> , foljet ndihmëse e modale, parafjalët, lidhëzat)
Java 4:	Sistemi emëror i shqipes dhe kategoritë gramatikore të tij; Temat emërore; Fazat e zhvillimit të temave emërore të shqipes; Paradigma e lakimeve
Java 5:	Sufiksats e shqipes: sufiksats fjalëformues e trajtëformues dhe sufiksats modifikativë-feminativë (-ë, -e, -eshë, -ushë, -onjë, -icë); Kategoria e gjinisë; Kategoria e numrit
Java 6:	Sistemi rator; Sistemi nyjor – nyja shquese dhe nyja e përparme
Java 7:	Sistemi mbiemëror – temat mbiemërore: temat e plota mbiemërore e temat jo të plota ose defektive mbiemërore dhe relacioni i tyre me mbaresën e gjinisë; Sistemi i numërimit (<i>KOLOKUIUMI 1</i>)
Java 8:	Sistemi përemëror: vetorët, vetvetorët, dëftorët
Java 9:	Sistemi përemëror: pronorët, pyetësit-lidhorët dhe përemrat e pacaktuar
Java 10:	Sistemi foljor i shqipes dhe veçoritë e tij; Paradigma e zgjedhimeve: zgjedhimi <i>-mi</i> dhe zgjedhimi <i>-o/-io</i> (I, II, III e IV)
Java 11:	Kategoritë gramatikore të foljes: veta, numri, mënyra (<i>DORËZIMI I SEMINAREVE</i>)
Java 12:	Kategoritë gramatikore të foljes: koha, diateza
Java 13:	Format e pashtjelluara sintetike dhe analitike të foljes
Java 14:	Kategoritë e paepueshme (<i>PREZANTIMET</i>)
Java 15:	Fjalëformimi; Sintaksa e fjalisë (<i>KOLOKUIUMI 2</i>)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme sipas përqindjes së përcaktuar në *Rregulloren për studimet themelore-Baçelor*, nr. 22, të datës 13.1.2022. Sipas saj, studenti është i obliguar të ndjekë të paktën 75% të ligjëratave dhe të ushtrimeve, që në praktikë nënkupton minimumi **12 javë vijueshmëri** nga 15. Lejohen deri në **3 javë mungesë** pa e rrezikuar të drejtën e pjesëmarrjes në vlerësim.

Ushtrimet, si pjesë integrale e kursit, kryhen në përputhje me përmbajtjen e leksioneve, për të lehtësuar përvetësimin e përmbajtjes së temës së trajtuar.

Detyrat dhe aktivitetet e specifikuar më sipër janë të detyrueshme si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Në orët e ushtrimeve rishikohen detyrat javore dhe monitorohet procesi i realizimit të kërkimit.

Gjatë orëve të mësimi lejohet dhe inkurajohet përdorimi i pajisjeve mobile dhe i platformave online në përputhje me qëllimet e kursit. Me rastin e hartimit të punimeve dhe prezantimeve semestrale, studentët inkurajohen të përdorin aplikacione kompjuterike.

Në komunikim me studentët dhe gjatë gjithë procesit të aktiviteteve akademike do t'u kushtohet rëndësi parimeve të përcaktuara në *Kodin e etikës për personelin akademik të UP-së*, nr. 1/868, të datës 24.7.2025.

Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim u nënshtrohen masave disiplinore në përputhje me rregulloret e UP-së.